



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
SEKRETARIA

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ .01.2021

**MBLEDHJA Nr. 02,**  
**datë 15.01.2021, ora 12:30**  
**e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; të ndryshuar, (ii) Rregullores bazë së Organizimit dhe Funkcionimit të Entit Rregullator të Energjisë të miratuar me Vendimin e ERE-s Nr. 144/2019 dhe (iii) nenit 11 të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96, datë 16.07.2016, (iv) Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 24.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të vecanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19”, të ndryshuar, njoftojmë se **ditën e Premte, datë 15.01.2021, ora 12:30**, do të zhvillohet mbledhja nr. 02 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

- 1- Mbi kërkesën e shoqërisë OST sh.a, për zgjatjen e afatit për rishikimin e Vendimit të Bordit të ERE-s, Nr. 169, datë 03.11.2020, “Për shqyrtimin e planit të investimeve për vitin 2020 dhe atë të përditësuar dhjetëvjeçar 2015-2025 të zhvillimit të rrjetit të transmetimit të shoqërisë OST sh.a;
- 2- Mbi kërkesën e FSHU sha për disa ndryshime në “Kontratën TIP për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/ Kesh sh.a, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe furnizuesi i shërbimit universal/FSHU sh.a. për furnizimin e klientëve fundorë;
- 3- Mbi anulimin e Vendimit të Bordit të ERE Nr. 226, datë 15.12.2020 mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës Nr. 209, seria TL3, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “SHUTINA ENERGJI” sh.p.k., me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 109, datë 01.10.2013;
- 4- Mbi kërkesën e Albgaz për shtyrjen e afateve të përcaktuara në rregulloren e kriterëve standarde dhe kërkesave minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit të rrjeteve të gazit natyror
- 5- Mbi miratimin e formularit të përditësuar të ankesave të klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror
- 6- Çështje të tjera

Në zbatim të pikës 1 të Urdhërit të kryetarit të ERE-s nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19”; Urdhërit nr. 53/1, datë 24.03.2020 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 53, datë 11.03.2020”, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore” dhe Urdhërit nr. 53/2 datë 01.06.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19, mbledhja nuk do të jetë e hapur për publikun.

**KRYETARI I ERE**  
**Petrit AHMETI**